



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKAI NA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO

Pranim / Dorezime / Prenepred / Predato / Recieved / Delivered	04-03-21	viti / mod / year
Organ / Ripresa / Organ / Ripresa / Org / Unit	970/2021	Sasia / Kolicina / Quantity
Art / Prot / Prot No		112
Shtesa / Prilog / Appendix		



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.22/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Arben Mehmeti, anëtar, Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 22/2021 të datës 21.01.2021 ka shqyrtuar ankesën e ankueses
. të parashtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar me adresë: Rruga ‘‘Besnik Osmani’’, në Ferizaj, kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike ‘‘ndërprerje e marrëdhënies së punës’’, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.03.2021 mori këtë;

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 22/2021 të datës 21.01.2021 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, me datë 02.11.2020 ka parashtruar kërkesë tek Komisioni për ankesa në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për kthim në vendin e punës, pasi që nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën e saj, me datë 21.01.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 252/2021 e regjistruar me numër A.nr.22/2021 kundër Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me rastin e përfundimit të Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta me Nr.2295 të datës 16.06.2017, në pozitë Anëtare e Sekretarisë së Komisionit për Verifikimin e Diplomave të Lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesë e datës 21.01.2021 e parashtruar nga grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 02.11.2020; Vendim i datës 08.05.2018; Vendimi i datës 04.05.2017; Vendimi nr.2727/2016 i datës 15.06.2016; Vendimi Nr.2-4424 i datës 15.09.2016; Vendimi i datës 14.06.2017; Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta me Nr.2295 të datës 16.06.2017; Flete lëshim i datës 13.09.2018 me raporte dokumente mjekësore.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës konteston se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesat e parashtruara nga ankuesja

repse:



Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi me datë 15.06.2016 ka lidhur Marrëveshje për Shërbime të Veçanta në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e cila marrëveshje i është vazhduar me Vendimin e Qeverisë me Nr.05/144 të datës 04.05.2017, dhe me Vendimin me Nr.105/45 të datës 08.05.2018, i vazhduar edhe për një vit, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi, gjegjësisht deri me datë 08.05.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka kontestuar sepse ankuesja ka themeluar marrëdhënieje të punës me *Marrëveshje për Shërbime të Veçanta* me afat të caktuar, dhe e drejta e informimit dhe ankimit është e përcaktuar në nenin 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcakton se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e ankuseses udhëzon ankuesen, *për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/ L-114 për Zyrtarët Publikë*.

Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është kompetent për të vendosur vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, siç është e përcaktuar në nenin 2 paragrafin 2, nën paragrafin 2.1, paragrafin 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik. Andaj, duke marr parasysh konstatimin se të punësuarit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, nuk kanë statusin e nëpunësit civil, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A. Nr. 22/2021

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Zyle Milaku GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë në Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

